



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPËSTINA VUÇITRIN	
02 Nr. / Br	695-1/25
Nr. i fq. / Br. st	
Data: / Datum	16.06.2025
VUSHTRRI - VUÇITRIN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 qershor 2008) dhe nenin 43 paragrafi 12 të Statutit të Komunës, me rastin e shënimit të përvjetorit – Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, Kryetari i Komunës me datën 17 qershor 2025 merr këtë:

V E N D I M PËR NDARJE TË MIRËNJOHJEVE

1. Me rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë iu ndahen mirënjohje personaliteteve si në vijim:
 - 1.1 **Hashim Krasniqi** (post mortum), për kontributin e dhënë në organizimin e luftës së UÇK-së,
 - 1.2 **Safet Ahmeti**, për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së,
 - 1.3 **Shyqyri Bunjaku**, për kontributin e dhënë në vitet e 90-ta për mbijetesë të arsimit shqip në Komunën e Vushtrrisë, si dhe ushtrimin e pozitës së drejtorit të shkollës në ato vite,
 - 1.4 **Izet morina**, për kontributin e dhënë në vitet e 90-ta për mbijetesë të arsimit shqip në Komunën e Vushtrrisë, si dhe ushtrimin e pozitës së drejtorit të shkollës në ato vite,
 - 1.5 **Isak Bajrami** (post mortum), për kontributin e dhënë në vitet e 90-ta për mbijetesë të arsimit shqip në Komunën e Vushtrrisë, si dhe ushtrimin e pozitës së drejtorit të shkollës në ato vite,
 - 1.6 **Sejdi Uka**, (post mortum),
 - 1.7 **Enver Jusufi, baba i dëshmorit** (post mortum),
 - 1.8 **Hajdin Klinaku, baba i dëshmorit**,
 - 1.9 **Bislim Kutlllovci, baba i dëshmorit**,
 - 1.10 **Bajram Zymer Zymeri** (post mortum), për kontributin e dhënë në përkrahje të luftës së UÇK-së,
 - 1.11 **Hamit Mumin Hama**, për kontributin e dhënë në përkrahje të luftës së UÇK-së,
2. Dorëzimi i mirënjohjeve do të bëhet me datën 17 qershor 2025 me rastin e mbajtjes së Akademisë solemne e cila do të mbahet në këtë ditë.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport
- Arkivit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	29165/25
Nr. / fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	22.06.25
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

02Nr. 734/25

Datë, 27.06/2025

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të kërkesës së Drejtorisë për Administratë dt. 07.06.2024, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet puna me palë në Drejtorinë për Administratë - Zyrën e gjendjes Civile dhe Qendrën për Shërbim me Qytetarë, ditëve të shtuna, nga ora 09:00-14:00, nga data 05 korrik deri më 31 gusht 2025, për shkak të rritjes së fluksit të palëve/bashkatdhetarëve të ardhur nga diaspora, në mënyrë që të iu ofrohen mundësi për furnizim me dokumente personale.
2. Obligohet Drejtoresha për Administratë që të i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Administratë
- QSHQ
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br 29170125
- 1 -
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 27.06.25
VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

02Nr. 733 /25
Datë, 27.06/2025

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet puna me palë në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa – shërbimi i arkës, për kryerje të pagesave ditëve të shtuna nga ora 09:00-14:00 nga data 05 korrik deri më 31 gusht 2025, për shkak të rritjes së fluksit të palëve/bashkatdhetarëve të ardhur nga diaspora, në mënyrë që të iu ofrohen shërbime sa më cilësore.
2. Obligohet Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- QSHQ
- Arkivit